

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

ledia.dushku@asa.edu.al

FRONI I MUNGUAR: PËRPPJEKJET E WILHEM VON WIED-IT PËR LEGJITIMITET NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Abstrakt:

Artikulli ka në fokus përpjekjet e Princit Wilhelm von Wied për të riafirmuar legjitimitetin e tij mbi fronin shqiptar gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, në kontekstin e një boshllëku të theksuar politik, si në terren ashtu edhe në arkitekturën ndërkombëtare. Pas largimit nga Shqipëria, Wied-i kërkoi rikthimin si sovran legjitim, ndërkohë që elitat shqiptare mbetën të ndara midis mbështetësve të tij dhe atyre që promovonin alternativa të ndryshme politike. Roli i Fuqive të Mëdha, veçanërisht i Austro-Hungarisë, rezultoi vendimtar në përcaktimin e fatit të tij dhe të mbështetjes që do t'i ofrohej nga elitat politike shqiptare.

Në përpjekjet për rikthim, Wied-i ndoqi një strategji të shumanshme, duke u përqendruar fillimisht në mjete ushtarake dhe në vijim edhe në ato diplomatike e propagandistike. Megjithatë, Fuqitë e Boshtit nuk e panë rikthimin si një opsion realist. E fokusuar në kontrollin e drejtpërdrejtë të Shqipërisë, Austro-Hungaria e izoloi politikisht Wilhelm von Wied-in, kufizoi komunikimin me mbështetësit në Shqipëri dhe ndaloi këta të fundit të propagandonin në favor të tij. Në dallim Gjermania, nuk e pati Shqipërinë si prioritet strategjik dhe nuk ndërmori hapa konkretë për mbështetjen e Princit, duke i qëndruar besnike linjës së Vjenës.

Artikulli arrin në përfundimin se mungesa e një autoriteti të konsoliduar në Shqipëri dhe ndryshimi i prioriteteve të Fuqive të Mëdha, shoqëruar me mungesën e mbështetjes ndërkombëtare, shpjegojnë dështimin e Princ Wied-it për të transformuar legjitimitetin formal në autoritet të ushtruar në praktikë.

Fjalë kyç:

Wilhelm von Wied, Lufta e Parë Botërore, Shqipëri, Austro-Hungari, legjitimitet, promemorie, rrjete mbështetëse.

Hyrje

Shqipëria e shpalli pavarësinë më 28 nëntor 1912, në një kontekst të ndërlikuar politik dhe ushtarak, ndërsa Ballkani ishte përfshirë në konfliktet e Luftës së Parë Ballkanike. Që prej tetorit shtetet fqinje – Serbia, Greqia dhe Mali i Zi – kishin ndërmarrë një ofensivë të gjerë kundër Perandorisë Osmane, ndërsa kishin pushtuar pjesë tërësore të vilajeteve në Rumeli, përfshirë edhe territoret me shumicë shqiptare. Zhvillimet e befta dhe ecuria e luftës në favor të aleatëve ballkanikë, përbënin një sfidë të drejtpërdrejtë për projektin shtetformues të shqiptarëve, në kushtet kur aspiratat territoriale të fqinjëve ishin të qarta dhe synonin të pengonin krijimin e një entiteti të pavarur politik, me shtrirje në të gjithë hapësirën ku jetonin shqiptarët.¹ Shpallja e Pavarësisë nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës, si një akt politik me karakter shkëputës nga Perandoria Osmane, nuk u njoh menjëherë nga Fuqitë e Mëdha. Vetëm më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër mori vendimin final për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, neutral dhe nën mbikëqyrjen e Fuqive të Mëdha.

Për të garantuar stabilitetin e tij, Fuqitë e Mëdha vendosën në krye Princin gjerman, të besimit protestant, Wilhelm von Wied, i cili mbërriti në Durrës më 7 mars 1914. Përpjekjet për të ndërtuar një administratë funksionale u përballën me sfida të shumta, të cilat buronin nga fragmentarizimi dhe destabilizimi i brendshëm, ndërhyrjet e shteteve fqinje dhe të Fuqive të Mëdha, mungesa e burimeve financiare dhe konteksti i ndërlikuar gjeopolitik i rajonit.² Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore në gusht 1914 e përkeqësoi ndjeshëm situatën. Fuqitë e Mëdha, të cilat ishin garantuese të pavarësisë dhe integritetit territorial shtetëror, u përfshinë drejtpërdrejt në konflikt, duke lënë mënjanë angazhimet e marra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Konfrontimi mes tyre

¹ Ledia Dushku, “From Ottomans to Albanians: The First Balkan War and the Proclamation of Albanian Independence (October-November 1912)”, *Istorijska 20. Veka* 1 (2024): 2-7.

² Nicola Guy, *The Birth of Albania: Ethnic Nationalism, the Great Powers of World War I and the Emergence of Albanian Independence* (London: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2012), 72-86.

nënkuptonte zhbërjen juridike të marrëveshjeve paraprake, përfshirë edhe garancinë për mëvetësinë shqiptare. Në këtë kontekst, vazhdimësia e kurorës së Princ Wied-it dhe më gjerë, fati i shtetit shqiptar nuk do të përbënin më një prioritet për politikën europiane.

Përballë revoltave të brendshme, mungesës së mbështetjes nga Fuqitë e Mëdha dhe financave shtetërore thaujse të zbrazëta, më 3 shtator 1914, Wied-i u largua nga Shqipëria. Në deklaratën e tij drejtuar shqiptarëve, para nisjes nga Durrësi, ai nuk shpalli abdikimin nga froni, madje theksoi se largimi për në Europë bëhej me qëllimin e vetëm “për të mos e lënë veprën të papërfunduar”.

“Dijeni, – nënvizonte Princi në përmbyllje të deklaratës, – sesi larg, ashtu edhe afër, unë do të kem vetëm një mendim, që të punoj për të mirën e popullit tim fisnik dhe të guximshëm shqiptar”.³

Megjithëse ikja nga Shqipëria shënoi fundin e pranisë aktive të Wilhelm von Wied-it në politikën shqiptare, legjitimiteti i tij si sundimtar i Principatës Shqiptare nuk u kundërshtua menjëherë në nivel ndërkombëtar. Kjo ndodhi për shkak të mungesës së një zgjidhjeje të re të koordinuar midis Fuqive të Mëdha, të cilat, të përfshira thellësisht në Luftën e Parë Botërore, nuk kishin një konsensus rishtar për zëvendësimin e tij, ndërkohë që rendi diplomatik në Ballkan e më gjerë mbeti i paqëndrueshëm. Në këtë kuadër, njohja ndërkombëtare e Wied-it si Princ i Shqipërisë, mbeti më shumë një *status quo* diplomatike e pashpallur dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, pretendimi i tij për fronin shqiptar mbeti i hapur. Përpjekjet për t’u rikthyer në pushtet u bënë pjesë e ekuilibrave diplomatikë të konfliktit global, ndërsa segmente të politikës shqiptare vijuan të shpresonin rikthimin e “Mbretit”, si një mënyrë për të rivendosur stabilitetin dhe autoritetin e shtetit të njohur ndërkombëtarisht.

Për të ndriçuar këto përpjekje në kuadër të një narrative historike, artikulli përdor një kornizë teorike ndihmëse, e cila kombinon tri paradigma analitike: ndërtimin e shtetit (state-building), sundimin e deleguar/ të ndërmjetëm (proxy rule) dhe konceptin e legjitimitetit sipas

³ Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSSt.A.PA.A.), në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH), Vj. 24-13-1335. Telegram i Sami Bej Vrionit drejtuar agjencisë së lajmeve “Stefan”, në të cilin transmeton deklaratën e Princ Wied-it drejtuar shqiptarëve nga Durrësi, Romë, 5 shtator 1914.

Max Weber-it. Të tria së bashku, ato shërbejnë si lente analitike për të kuptuar jo vetëm dështimin individual të Wilhelm von Wied-it, por edhe kushtet strukturore që e bënë të pamundur institucionalizimin e autoritetit të tij, në një hapësirë të fragmentuar si Shqipëria e viteve të Luftës së Parë Botërore.

Ndërtimi i shtetit, sipas qasjes së studiuesve Charles Tilly dhe Joel Migdal, nënkupton procese afatgjata të përqendrimit të forcës dhe të burimeve, krijimin e institucioneve të qëndrueshme, si edhe ushtrimin e forcës së ligjit vetëm nga autoriteti qendror.⁴ Në dallim nga modelet klasike të shteteve perëndimore, Shqipëria e vitit 1914 paraqitej një shtet i dobët, i karakterizuar nga një shoqëri tradicionale e fortë, me fragmentarizim të theksuar të autoritetit, të shpërndarë në struktura fisnore, krahinore dhe klienteliste. Ndikimi i jashtëm, historikisht kishte qenë i vazhdueshëm, duke theksuar edhe më tej mungesën e një autonomie të brendshme. Në këtë kontekst, përpjekjet e Wilhelm von Wied-it për të ndërtuar një administratë funksionale dhe të qëndrueshme u përballën me një strukturë shoqërore të paunifikuar, me pasivitetin, madje edhe me kundërshtimin e segmenteve të elitës vendëse, që shpesh vepronte në funksion të interesave personale apo në varësi të fuqive ballkanike ose europiane. Si rrjedhojë, Princi nuk arriti të ndërtonte as kapacitetin infrastrukturor të shtetit, as një rrjet të qëndrueshëm mbështetësish që do t'i siguronin legjitimitet të brendshëm dhe autoritet efektiv.⁵

Nga ana tjetër, *sundimi i deleguar* nënkupton një formë qeverisjeje ku autoriteti lokal vendoset ose mbështetet nga një fuqi e jashtme, shpesh për qëllime të stabilitetit rajonal ose të balancës ndërkombëtare të forcës. Kjo qasje lidhet ngushtë me konceptin e *sovrانيتit të kushtëzuar* të Stephen Krasner-it, i cili vëren se në shumë raste sovraniteti shtetëror

⁴ Charles Tilly, *Coercion, Capital, and European States, AD 990-1992* (Oxford: Basil Blackwell, 1992); Joel S. Migdal, *Strong Societies and Weak States: State-Building in the Third World* (Princeton: Princeton University Press, 1988).

⁵ Sipas sociologut Michael Mann, kapaciteti infrastrukturor i shtetit nënkupton aftësinë e tij për të zbatuar vendime dhe për të ushtruar kontroll efektiv në të gjithë territorin, përmes një rrjeti administrativ, ligjor dhe ushtarak. Ai përbën fuqinë reale të shtetit për të ndërhyrë dhe për të organizuar jetën shoqërore në mënyrë të qëndrueshme dhe të centralizuar. Shih: Michael Mann, "The Autonomous Power of the State: Its Origins, Mechanisms and Results", në *Journal of Sociology/Archives Européennes de Sociologie*, Vol. 25, No. 2, Tending the roots: nationalism and populism (1984): 185-213.

është më shumë një normë e pretenduar sesa një realitet funksional.⁶ Në rastin e Wied-it, vendosja e tij në fron ishte një zgjidhje kompromisi e Fuqive të Mëdha, që kishte si qëllim më tepër administrimin e krizës ballkanike sesa krijimin e një shteti të qëndrueshëm shqiptar. Për pasojë, Princi operoi nën një mbikëqyrje kolektive ndërkombëtare, përmes Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe ndikimit të fortë të Austro-Hungarisë e Italisë, çka e kufizoi pavarësinë e tij. Për pasojë, Wied-i jo vetëm që nuk pati kontroll efektiv mbi shtetin, por përpjekjet e tij për rikthimin e legjitimitetit si sundimtar i Shqipërisë, mbetën të brishta dhe të kontestuara.

Në këtë kontekst, koncepti weberian i legjitimitetit është thelbësor për të kuptuar pamundësinë e Princit për të institucionalizuar autoritetin e tij si sundimtar dhe pretendues për fron. Max Weber identifikon tri forma themelore të legjitimitetit: *tradicional*, i mbështetur në traditë dhe vazhdimësinë dinastike; *karizmatik*, që buron nga besimi në cilësitë e jashtëzakonshme të një drejtuesi shteti; *legal-racional*, i cili mbështetet në rregulla të kodifikuara dhe institucione formale.⁷ Wied-i nuk gëzonte legjitimitet tradicional, pasi nuk kishte lidhje me ndonjë dinasti shqiptare apo ndonjë traditë vendore të pushtetit. Ai nuk mundi të krijonte një legjitimitet karizmatik, si rrjedhojë e karakterit të tij të rezervuar, nivelit të pamjaftueshëm të njohjes dhe lidhjeve përgjithësisht sipërfaqësore me elitat dhe vendësit. Legjitimiteti legal-racional, rrjedhojë e njohjes ndërkombëtare si princ sovran, ishte më shumë formal sesa funksional, pasi në praktikë ai nuk zotëronte as kapacitetin, as mekanizmat për të ushtruar pushtet efektiv. Kjo situatë përbën një ilustrim të qartë të “legjitimitetit të fragmentuar”,⁸ që nuk u konvertua dot në autoritet dhe mbështetje reale.

⁶ Stephen D. Krasner, “Abiding Sovereignty”, *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*, Vol. 22, No. 3, Transformation of International Relations: Between Change and Continuity. Transformations des relations internationales: entre rupture et continuité (July 2001): 229-251.

⁷ Max Weber, *Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology*, ed. Guenther Roth and Claus Wittich (Berkeley, Los Angeles, London: University of California Press, 1978), 212-297.

⁸ Termi “legjitimitet i fragmentuar” (fragmented legitimacy) i referohet një situatë në të cilën komponentët kryesorë të legjitimitetit politik – tradicional, karizmatik dhe legal-racional, sipas tipologjisë së Max Weber-it – janë të paqëndrueshëm, të paplotë ose kontradiktorë mes tyre. Në vend që këta komponentë të ndërveprojnë në mënyrë plotësuese për të konsoliduar autoritetin e sundimtarit, ata mbeten të ndarë ose të

Këto dobësi strukturore, të pranishme që në momentin e ardhjes së Wied-it në Shqipëri, u thelluan gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, kur legjitimiteti i tij mbeti peng i zhvillimeve ndërkombëtare dhe i politikave të Fuqive të Mëdha. Për pasojë, përpjekjet për rikthim nuk mund të kuptohen si thjesht aspirata personale, por si pjesë e një loje më të gjerë të ekuilibrave diplomatikë dhe dështimit të një modeli të transplantuar sundimi, në një mjedis politik të papërshtatshëm.

Deri më sot, studimet mbi Wied-in janë fokusuar kryesisht në periudhën e shkurtër të sundimit të tij përgjatë muajve mars-shtator 1914, duke lënë thuajse jashtë vëmendjes përpjekjet për kthim.* Ky artikull synon të plotësojë këtë boshllëk në literaturë, duke sjellë një analizë të detajuar të përpjekjeve të Princit për njohjen e legjitimitetit të tij mbi fronin shqiptar në rrethanat e Luftës së Parë Botërore. Analiza zhvillohet në tri plane: *së pari*, përmes shqyrtimit të iniciativave të grupeve të elitës politike shqiptare që kërkonin kthimin e “Mbretit”; *së dyti*, duke analizuar strategjinë e vetë Wied-it për të riafirmuar legjitimitetin e tij; *së treti*, përmes vlerësimit të qëndrimeve të Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë ndaj kësaj çështjeje.

Aktorët politikë shqiptarë në riafirmimin dhe kundërshtimin e legjitimitetit të Wied-it

Aktivizmi politik i shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore përfaqëson një përpjekje të ndërlikuar për të riafirmuar, ose kundërshtuar, legjitimitetin e Princit Wilhelm von Wied si kreu i ligjshëm i Principatës Shqiptare. Në kushtet e pushtimeve të njëpasnjëshme nga shtetet

papërbushur, duke çuar në mungesë kohezioni institucional dhe mbështetjeje shoqërore. Në rastin e Princ Wied-it, mungesa e një baze të qëndrueshme për secilin prej këtyre komponentëve ndikoi që pushteti i tij të mbetej i brishtë dhe i sfiduar, pa mundur të konsolidohej në mënyrë efektive në praktikë. Ky kuptim i legjitimitetit të fragmentuar është i krahasueshëm me raste të analizuara në literaturën e shkencave politike, ku shtete në tranzicion, ose me institucione të dobëta, prodhojnë forma të fragmentuara të legjitimitetit. Shih David Beetham, *The Legitimation of Power* (Basingstoke: Macmillan, 1991), 15-27; Tomonori Teraoka, “Fragmented Legitimacy: The Rhetorical Construction of Constitutional Legitimacy in Postwar Japan,” *Japanese Journal of Political Science* 21, nr. 2 (2020): 346-372.

<https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/23801883.2020.1855080>

* Pak kontribute mbi këtë temë, në Shqipëri janë realizuar nga prof. asoc. dr. Sali Kadria dhe prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, punimet e të cilëve janë përfshirë në referencat bibliografike të këtij artikulli.

ballkanike dhe Fuqitë e Mëdha (Italia, Austro-Hungaria dhe Franca), klasa politike shqiptare mbeti e ndarë midis atyre që kërkonin të ruanin autoritetin e Wied-it si simbol i njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar dhe atyre që synonin krijimin e një alternative politike pa përfshirjen e Princit gjerman. Në këtë kontekst, roli i Fuqive të Mëdha do të ishte vendimtar në përcaktimin e fatit të Shqipërisë. Austro-Hungaria, e cila deri në verën e vitit 1916 kishte pushtuar dy të tretat e territorit të shtetit shqiptar, zgjodhi të ndiqte një politikë pragmatike që favorizonte interesat e saj strategjike në Ballkanin e përfshirë në flakët e luftës. Nga ana tjetër, Italia kërkonte të zgjeronte dhe të konsolidonte ndikimin e saj në Shqipërinë e Jugut, duke pasur pretendime edhe për zotërimin e Durrësit, kryeqytetin e Principatës Shqiptare. Ajo e shihte me skepticizëm rikthimin e Wied-it, duke u përpjekur të krijonte struktura alternative qeverisëse nën mbikëqyrjen e saj nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve me përfaqësues të elitës politike shqiptare me influencë ndër shqiptarë, sikurse ishte Esad Pashë Toptani.⁹ Ndikim ushtroi edhe Franca, e cila kishte pushtuar Korçën e zonat përreth dhe Shqipërinë e shihte si një territor të hapur për lëvizje diplomatike. Varësia strukturore nga këto fuqi i detyroi politikanët shqiptarë të manovronin mes interesave personalë, kombëtarë e ndërkombëtarë, duke u përpjekur të siguronin mbështetje për opsionet e tyre politike.

Riafirmimi i legjitimitetit të Wied-it: Përpjekjet për rikthimin e Wied-it ishin pjesë e një panorame të gjerë të manovrave politike që karakterizuan elitën shqiptare në vitet e Luftës së Parë Botërore. Një grupim me peshë, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme, ku spikatnin Aqif Pashë Biçaku dhe Ahmet Zogu, mbështeti rikthimin e Princit. Aqif Pashë Biçaku, bilonjë e një prej familjeve më në zë në Elbasan, kishte qenë ministër i Brendshëm në qeverinë e Wied-it dhe njihej për lojalitetin e tij

⁹ Në lidhje me marrëdhëniet e Italisë me Esad Pashë Toptanin në fazën e parë të Luftës së Parë Botërore, shih: *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri* (më tej: *ASDMAE*), Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Albania, Pacco 14, fasc. 390. Telegram i legatës italiane në Durrës për Ministrinë e Jashtme, Durrës, 12 dhjetor 1915; *HHSSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 24-22-2255. Raport nga Durrësi drejtuar kontit Berchtold në Vjenë, 31 tetor 1914; *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 486 (koleksion dokumentesh), Viti (më tej: V.) 1915, Dosja (më tej: D.) 665, fleta (më tej: fl.) 227. Letër e Esad Pashës, kryetar i qeverisë drejtuar prefekturës së Beratit, Durrës, më 24 nëntor 1915; Ilir Ikononi, *Esad Pashë Toptani. Njeriu, lufta, pushteti* (Tiranë: UET Press, 2016), 361-363.

ndaj Austro-Hungarisë. Edhe pas largimit të Princit, ai vijoi të vepronte në favor të ruajtjes së trashëgimisë politike të Principatës, duke mbetur një “partizan besnik” i Wied-it.¹⁰ Ahmet Zogu, pinjoll i familjes Zogolli, kishte influencë politike dhe ekonomike në zonën e Burrelit dhe lidhje farefisnie me familjen Toptani në Shqipërinë e Mesme. Ai ishte përfaqësues i grupimit të njohur si “partia nacionaliste”, që synonte krijimin e strukturave qeverisëse kombëtare si një formë administrimi të përkohshëm, në pritje të kthimit të Wied-it.¹¹ Në fillim të vitit 1916, të dy së bashku promovuan nismën për thirrjen e një kongresi kombëtar, që do të riafirmonte legjitimitetin e Wied-it si princ i Shqipërisë. Ideja u konkretizua më 3 mars, me anë të një njoftimi telegrafik që Ahmet Zogu, në cilësinë e kryetarit të komisionit nismëtar, u dërgoi drejtuesve të disa prefekturave e nënprefekturave në Shqipërinë e Mesme, si edhe diasporës shqiptare në Bukuresht, Sofje e Lozanë, të cilët më herët ishin deklaruar mbështetës të Princit. Parashikohej që kongresi të mbahej më 18 mars 1916, në Elbasan; ai do të kishte si qëllim diskutimin e administrimit tranzitor të Shqipërisë deri në rikthimin e Wilhelm Wied-it; zyrtarizimin e dëshirës së shqiptarëve për ardhjen sa më parë në Shqipëri të Princit; si edhe shprehjen e mirënjohjes ndaj “aleatëve të kombit shqiptar”, duke veçuar këtu Austro-Hungarinë, të cilën e konsideronte si “njohëse e të drejtave kombëtare të shqiptarëve”.¹² Ndërkohë, nga Shqipëria dhe diaspora, Princit iu dërguan telegrame mbështetëse, që i kërkonin kthimin e tij në atdhe.¹³

Nisma për mbajtjen e kongresit përfaqësonte një përpjekje të rëndësishme edhe për krijimin e një autoriteti të përkohshëm qeverisëse shqiptar, drejtimi i të cilit do t’i besohej Aqif Pashë Biçakut, ndërsa në poste ministrore do të përfshiheshin figura nacionaliste dhe ish-anëtarë të

¹⁰ *HHSSt.A.PA.A.*, në *AIH*, Vj. 26-6-634. Telegram i togerit von Zitkovski në Elbasan drejtuar Kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze në Shkodër, Elbasan, 12 mars 1916.

¹¹ *Po aty*, Vj. 26-18-1850. Raport i komandës austro-hungareze në Elbasan për komandën e brigadës malore në Tiranë, Elbasan, më 9 mars 1916.

¹² Sali Kadria, *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, ASA/Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020), 269.

¹³ Joseph Swire, *Albania – The Rise of a Kingdom* (New York: Arno Press & New York Times, 1971), 261.

kabinetit të Princ Wied-it.¹⁴ Mbështetësit e këtij projekti, që ishin jo të paktë në numër, synonin të siguronin nga autoritetet ushtarake austro-hungareze njohjen dhe përkrahjen e Princit si i vetmi autoritet legjitim politik, përfaqësues i Shqipërisë zyrtare. Kërkesa e tyre argumentohej me faktin se Aqif Pasha kishte shërbyer më parë si ministër në qeverinë e drejtuar nga Turhan Pashë Përmeti. Për shkak të pushtimit, qeveria shqiptare do të duhej të funksiononte si një administratë provizore nën mbikëqyrjen e autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Për këtë arsye, kërkohet që Austro-Hungaria të dërgonte një përfaqësues të plotfuqishëm në Elbasan, mundësisht konsullin e Përgjithshëm August Kral, i cili vepronte si i dërguari diplomatik i Vjenës në Shkodër. Me plot të drejtë, ai konsiderohej si një figurë me njohuri të thella mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, dhe për këtë gëzonte besimin e gjerë të vendësve për të ndihmuar në riorganizimin e administratës civile, në përputhje me synimet e qeverisë austro-hungareze.¹⁵

Kongresi i Elbasanit synonte kështu të riafirmonte legjitimitetin e Wied-it, duke i dhënë Princit një bazë mbi të cilën ai mund të mbështeste pretendimin e tij për t'u rikthyer në Shqipëri. Wied-i konsiderohej simbol i ekzistencës kombëtare dhe i jetës shtetërore, përmes të cilit kërkohet të garantohej vazhdimësia e shtetit shqiptar në kushtet e pushtimit austro-hungarez.¹⁶ Megjithatë, ndërhyrja e Austro-Hungarisë¹⁷ e pengoi realizimin e këtij projekti dhe e bëri të pamundur krijimin e një administrate të qëndrueshme kombëtare, si iniciativë e shqiptarëve. Më tej, largimi i detyruar i Ahmet Zogut në Vjenë dhe politikëbërja austro-hungareze ndikuan ndjeshëm në dinamikën e brendshme, duke vështirësuar dhe duke penguar konsolidimin e idesë së rikthimit të Princit në skenën politike shqiptare.

Këto përpjekje të elitave shqiptare përfaqësojnë një rast ilustrues të konceptit të Joel Migdal-it mbi konfliktin ndërmjet strukturave shoqërore

¹⁴ *HHSSt.A.P.A.A.*), në *AIH*, Vj. 26-6-634. Telegram i togerit von Zitkovski në Elbasan drejtuar Kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze në Shkodër, Elbasan, 12 mars 1916.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 26-18-1850. Raport i komandës austro-hungareze në Elbasan për komandën e brigadës malore në Tiranë, Elbasan, më 9 mars 1916.

¹⁶ *Po aty*, Vj. 26-6-634. Telegram i togerit von Zitkovski në Elbasan drejtuar Kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze në Shkodër, Elbasan, 12 mars 1916.

¹⁷ Në lidhje me mekanizmat e përdorur nga autoritetet austro-hungareze të pushtimit, shih: Kadria, *Nacionalizmi shqiptar*, 272-273.

të forta dhe shtetit të dobët.¹⁸ Në mungesë të një autoriteti qendror efektiv, Aqif Pashë Biçaku dhe Ahmet Zogu ndërморën përpjekje për të ngritur institucione të përkohshme qeverisëse në pritje të rikthimit të Wied-it, të mbështetura në një formë legjitimiteti legal-racional. Megjithatë, këto iniciativa nuk u zhvilluan në kushtet e një sovraniteti të plotë, por si pjesë e një marrëdhënieje të ndërvarur me pushtetin ushtarak austro-hungarez. Kjo situatë përputhet me modelin e sundimit të ndërmjetëm, ku elitat vendëse veprojnë si aktorë të deleguar, të varur nga një fuqi e jashtme që mban monopolin e forcës dhe vendimmarrjes politike.¹⁹

Pavarësisht këtyre sfidave, nacionalistët brenda vendit vazhdonin ta shihnin Wied-in si simbol të legjitimitetit shtetëror dhe të mbështetnin rikthimin e tij. Me afrimin e fundit të luftës, në disa qytete kryesisht në Shqipërinë e Mesme (Durrës, Elbasan, Kavajë, Tiranë dhe Fier) u organizuan manifestime popullore për të përkujtuar ardhjen e tij në Shqipëri, më 7 mars 1914.²⁰ Në këto organizime vijoi të spikaste Aqif Pashë Biçaku dhe personalitete të tjera elbasanase si Lef Nosi e Ahmet Dakli, por, përkundër mbështetjes popullore, mungesa e përkrahjes nga Austro-Hungaria nuk stimuloi një reagim intensiv të shqiptarëve në dobi të rikthimit të Princit.

Kundërshtimi i legjitimitetit të Wied-it: Krahas sa më sipër, ekzistonin edhe projekte alternative që synonin krijimin e një forme tjetër të shtetit shqiptar, duke përjashtuar Princin gjerman.

Një nga projektet e artikuluara në këtë drejtim, ishte ai i Hasan Basri Beut, një figurë me ndikim lokal në zonën e Dibrës, ish-deputet në Parlamentin Osman. Ai synonte krijimin e një principate shqiptare me një princ bullgar në krye. Kjo iniciativë, e promovuar në fillim të vitit 1916, thuajse në të njëjtën kohë kur ishte hedhur ideja e Kongresit të Elbasanit, kundërshtonte rikthimin e Wied-it dhe paraqitej si një alternativë ndaj

¹⁸ Migdal, *Strong Societies and Weak States*, 3-10.

¹⁹ David A. Lake, *Hierarchy in International Relations* (Ithaca and London: Cornell University Press, 2009), 53-54.

²⁰ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-33. Raport i A. Kral-it për ministrin e Punëve të Jashtme, Shkodër, 14 mars 1918. Shih edhe Lef Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare*, Botim i dytë, përgatitja për botim dhe redaktimi shkencor nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka, Instituti i Historisë (Tiranë: Nënë Tereza, 2007), 268-270.

strukturës së mëparshme shtetërore.²¹ Duke e konsideruar projektin si një përpjekje të Bullgarisë për të zgjeruar ndikimin në Shqipëri, Austro-Hungaria e konsideroi atë si një kërcënim të drejtpërdrejtë për interesat e saj. Për këtë arsye, në prill 1916, Vjena vendosi të ndërhynte për të neutralizuar ndikimin e Hasan Basri Beut duke e internuar atë dhe duke shmangur çdo përpjekje për destabilizim.²²

Projekti i mësipërm nuk ishte i vetmi që synonte zëvendësimin e Princ Wied-it me një tjetër sovran të huaj. Një alternativë u propozua edhe nga Faik Konica, intelektual dhe figurë e rëndësishme nacionaliste që zhvillonte aktivitetin e tij jashtë Shqipërisë. Ai kërkoi vendosjen e Principatës Shqiptare nën drejtimin e një princi mysliman, në aleancë me Perandorinë Osmane dhe Austro-Hungarinë. Në promemorien e datës 9 shkurt 1916, drejtuar autoriteteve të larta në Stamboll, Konica propozoi hartimin e një programi të përbashkët shqiptaro-osman për rindërtimin e shtetit shqiptar, duke vendosur në krye një princ mysliman “pjesëtar të Familjes Perandorake Turke”.²³ Hapi i parë në këtë drejtim do të ishte krijimi i një komiteti me nacionalistë shqiptarë që vepronin në diasporë, i cili do të organizonte një qendër veprimi në Stamboll, Vjenë ose në Sofje.

Komiteti do të kishte për detyrë të neutralizonte me mjete propagandistike veprimtarinë e Princ Wied-it dhe të së shoqes, Princeshës Sophie. Nëpërmjet suksesit të kësaj veprimtarie, Konica pretendonte se mund të siguronte përkrahjen e Austro-Hungarisë, në kushtet kur mendohej se kjo e fundit nuk ishte entuziaste për rikthimin e Wied-it në Shqipëri. Hapi i radhës ishte konstituimi i një qeverie të përkohshme shqiptare brenda vendit, e cila do të merrte përsipër

²¹ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 26-6-642. Kryekomanda austro-hungareze për ministrin e Punëve të Jashtme, Teshen, 17 shkurt 1916. Transmeton letrën e Basri Beut për komandën austro-hungareze në Prizren; *po aty*, Vj. 26-6-644. Legata austro-hungareze në Sofje për Ministrinë e Luftës, Sofje, 4 shkurt 1916.

²² *Po aty*, Vj. 26-6-660. Informacion i atasheut ushtarak austro-hungarez në Sofje për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 17 mars 1916, *po aty*, Vj. 26-6-685. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme Burian drejtuar kontit Turn, Vjenë, 17 prill 1916; Kadria, *Nacionalizmi shqiptar*, 268.

²³ *AQSH*, F. 13 (Faik Konica), D. 2, fl. 1-6. Promemorie e hartuar nga Faik Konica për të sjellë në krye të fronit mbretëror shqiptar një princ turk mysliman, Konstandinopël, 9 shkurt 1916. Për një trajtesë të detajuar të promemories, shih: Sali Kadria, “Çështja e Princit të Shqipërisë dhe kontributi i Austro-Hungarisë për rrjetin e komunikacionit në viset shqiptare gjatë viteve 1916-1918”, *Kosova*, no. 43 (2018): 97-104.

organizimin e një kongresi për zgjedhjen e sovranit. Koordinatori kryesor i këtij plani pretendohet të ishte Mehmet Konica, delegati shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, në momentin e largimit Wied-i nga Shqipëria, të cilit ky i fundit i kishte dorëzuar pushtetin. M. Konica gëzonte mbështetje nga qarqet politike të Stambollit dhe shihej si një figurë legjitime për këtë mision. Në rast se ai nuk do të pranonte, atëherë vetë i vëllai, Faiku, do të merrte përsipër drejtimin e nismës.

Idetë e Konicës nuk gjetën mbështetjen e pritur nga qeveria austro-hungareze, e cila e shihte projektin si një kërcënim për interesat e saj në Shqipëri. Në një kohë kur Vjena nuk kishte ende një qëndrim të qartë mbi të ardhmen politike të Shqipërisë, ndërkohë që vijonin përplasjet mes ushtarakëve dhe diplomatëve në lidhje me këtë çështje,²⁴ ajo e konsideroi idenë e një princi mysliman si të papranueshme. Për këtë arsye, ndërhyri pranë aleates së saj osmane, duke kërkuar që të mos mbështeste një projekt të tillë.²⁵ Njëkohësisht, Konica u ftua për vizitë në *Ballhausplatz*, ku iu kërkuua të hiqte dorë nga çdo përpjekje për të vendosur në krye të Shqipërisë një princ mysliman.

Nga ana tjetër, megjithëse projekti gjeti përkrahje nga disa figura nacionaliste shqiptare të vendosura në Vjenë,²⁶ ai u përball me kundërshtimin e ashpër të Federatës Panshqiptare “Vatra” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila, në vijimësi të qëndrimeve të saj parimore, e kishte konsideruar të papranueshme vendosjen e një princi mysliman në krye të shtetit shqiptar.

“Mbreti i Shqipërisë [Wilhelm von Wied] është shumë popullor në mest të Shqiptarëve nacionalisë të Amerikës-s, si i pari mbret i

²⁴ Në lidhje me përplasjen mes diplomatëve dhe ushtarakëve austro-hungarezë për të ardhmen e Shqipërisë, shih: Marvin Benjamin Fried, *Austro-Hungarian War Aims in the Balkans during World War I* (Basingstoke, New York: Palgrave Macmillan, 2014); Ledia Dushku, “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914-1916)”, *Studime historike*, nr. 3-4 (2016): 73-90; Paskal Milo, “Politikat austro-hungareze ndaj Shqipërisë në vitet 1914-1918”, në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria (1916-1918)*, Aktet e konferencës shkencore, Tiranë, 26-27 janar 1918, redaktor shkencor Dorian Koçi, Marenglen Kasmi (Tiranë: Kristalina-KH, 2019), 25-39; Kurt Gostentschnigg, “Shtatmadhoria kundër Ballhausplatz-it: aneksim apo protektorat?”, në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, 71-78.

²⁵ *AQSH*, F. 13, D. 3, fl. 31-34. Letër e Faik Konicës drejtuar një personi të pidentifikuar, Baden, 25 prill 1916; *po aty*, fl. 45-46. Letër e Faik Konicës drejtuar një personi të pidentifikuar, Vjenë, 6 shtator 1916.

²⁶ Kadria, “Çështja e Princit të Shqipërisë”, 100.

Shqipërisë pa Skënderbeut, dhe idealizuar aq shumë sa ç' do goditje kundra tij do t'i lëndojë shumë atdhetarët tanë të pa-djallëzuar", shkruante Fan Noli, kryetar i Vatrës, në letrën dërguar Faik Konicës.²⁷

Presioni austro-hungarez, i kombinuar me kundërshtimin e rretheve nacionaliste shqiptare, e detyroi Faik Konicën dhe mbështetësit e tij të tërhiqeshin nga projekti.

Projektet e Hasan Basri Beut dhe Faik Konicës për të krijuar një alternativë ndaj Wilhelm von Wied-it dëshmojnë për fragmentarizimin e elitës politike shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Edhe veprimtaria e Esad Pashë Toptanit dhe bashkëpunimi i tij me Italinë dhe Antantën ndikuan në dobësimin e pozitës së Princ Wied-it brenda kuadrit politik shqiptar. Me nënshkrimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës (prill 1915), fuqitë e Antantës e shprehën qartë qëndrimin e tyre kundër Principatës Shqiptare, duke pranuar vetëm ekzistencën e një shteti autonom dhe të neutralizuar shqiptar, të kufizuar në qendër të Shqipërisë Londineze, ndarjen e Veriut dhe Jugut të Shqipërisë mes Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë.

Strategjia e Wilhelm von Wied-it për rikthimin në Shqipëri

Pavarësisht sfidave në mjedisin e brendshëm shqiptar dhe atë ndërkombëtar, Wilhelm von Wied nuk hoqi dorë nga aspiratat për fronin shqiptar. Në kontekstin e Luftës së Parë Botërore, ai hartoi një strategji të shumanshme për të riafirmuar legjitimitetin dhe për të siguruar mbështetjen e nevojshme ndërkombëtare për kthimin në Shqipëri.

Shtylla qendrore në strategjinë e Wilhelm Wied-it ishte ruajtja e lidhjeve me aleancën austro-gjermane. Pas largimit nga Shqipëria, ai kërkoi të rimerrej si oficer aktiv në ushtrinë perandorake gjermane, duke e konsideruar këtë angazhim jo vetëm si një detyrë ushtarake, por edhe si një lëvizje diplomatike që do të mbante të hapur opsionin politik për rikthimin në Shqipëri pas stabilizimit të situatës. Në kujtimet e tij, Wied-i e përlligjtte këtë vendim si një akt në shërbim të Shqipërisë, duke argumentuar se fitorja e Fuqive Qendrore do të përcaktonte fatin e pavarësisë shqiptare. Ai i raportonte Kajzerit se përfshirja në ushtrinë

²⁷ Refat Xh. Gurrazezi, *Historia e Federatës "Vatra"* (Tiranë: Globus R. 2006), 54.

gjermane ishte mënyra e vetme për të ndihmuar Shqipërinë.²⁸ Më 14 tetor 1914, ai u komandua në front si *Major à la suite* në Regjimentin e Tretë të Ulanëve Gardistë, në Shtabin e Divizionit të Kavalerisë së Gardës.

Ndërsa shërbente në ushtrinë gjermane, Wied-i vazhdoi të ndiqte nga afër zhvillimet në Ballkan. Fushata e suksesshme e ushtrisë austro-hungareze kundër Serbisë në fund të vitit 1914, i ngjalli atij shpresën për një rikthim të mundshëm në Shqipëri. Me nisjen e vitit 1915, ai filloi të shqyrtonte aktivisht këtë perspektivë, duke kërkuar një pozicion ushtarak që do t'i mundësonte kthimin, si pjesë e ofensivës së dytë austro-hungareze kundër Serbisë. Në ndryshim nga ofensiva e parë, ajo do të realizohej me mbështetjen e Gjermanisë, çka rriste mundësinë që Wied-i të kishte një rol të rëndësishëm. Më 24 shkurt 1915, në një letër drejtuar Kajzerit, ai kërkoi të merrte komandën e trupave gjermane që do të vepronin pranë ushtrisë austro-hungareze në këtë fushatë. Wied-i e arsyetonte kërkesën, duke u mbështetur në premtimin që u ishte dhënë shqiptarëve për t'u rikthyer sapo të krijoheshin rrethanat e favorshme, si edhe në mbështetjen e gjerë që ai pretendonte se gëzonte në radhët e tyre. Këto dy arsye përmendeshin prej tij, me synimin e qartë për të bindur Gjermaninë që ta përfshinte në planet e saj për rajonin.²⁹

Në kushtet e bllokadës detare në Adriatik, Wied-i e konsideronte rrugën tokësore përmes Serbisë si alternativën më të realizueshme për të mbërritur në Shqipëri, duke u bazuar në bindjen se ofensiva e re austro-hungareze do të rezultonte në një fitore të padiskutueshme. Fillimisht, Ministria e Jashtme austro-hungareze e përshëndeti nismën, ndërsa qeveria gjermane informoi Wied-in se do të përkrahte çdo vendim të Vjenës lidhur me fatin e tij. Por, në fillim të vitit 1915, marrëdhëniet austro-italiane u përkeqësuan ndjeshëm, duke çuar në përshkallëzim të tensioneve, që kulmuan me hyrjen e Italisë në luftë kundër Austro-Hungarisë. Përballë këtij zhvillimi, planet për një ofensivë të dytë kundër Serbisë u anuluan. Si rezultat, Gjermania nuk e konsideroi më të nevojshme përfshirjen e Wied-it në drejtimin e një komande pranë ushtrisë austro-hungareze, duke i dhënë fund perspektivës së momentit për rikthimin e tij në Shqipëri.

²⁸ Wilhelm von Wied, *Memorandum on Albania (1917)*,

http://www.albanianhistory.net/1917_Wied/index.html (shikuar më 25 janar 2024).

²⁹ *Po aty*, Marenglen Kasmii, *Wilhem Zu Wied dhe Shqipëria, mars-shtator 1914* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2023), 59.

Në vijim, Wilhelm von Wied iu kthye diplomacisë. Ai hartoi dy promemorie drejtuar Perandorit austro-hungarez dhe Kajzerit gjerman, si dhe ministrave respektivë të Punëve të Jashtme. E para u dërgua në korrik 1917, ndërsa e dyta në dhjetor të po atij viti, në një përpjekje të fundit për të bindur Fuqitë Qendrore se kthimi i tij do të forconte pozitën e tyre në rajon.³⁰

Një analizë e përgjithshme e promemorieve tregon se ato përqendroheshin në disa drejtime kryesore:

Pretendimi mbi fronin shqiptar dhe justifikimi ligjor: Wied-i theksonte se nuk kishte hequr dorë “për asnjë moment” nga të drejtat e tij mbi fronin, përkundrazi, shprehej ai, “vazhdoj t’i mbaj nga çdo pikëpamje plotësisht në këmbë pretendimet e mia mbi fronin e Shqipërisë independente”.³¹ Wied-i argumentonte se zgjedhja e tij si sovran nuk ishte një akt i rastësishëm apo personal, por rezultat i këmbënguljes austro-hungareze dhe i një marrëveshjeje ndërkombëtare, e cila i kishte njohur të drejtën për të sunduar mbi shtetin e pavarur shqiptar. Në këtë kuadër, ai e shihte veten jo vetëm si monarkun legjitim, por edhe si simbol të vazhdimësisë shtetërore, pavarësisht ndryshimeve politike dhe trazirave pas largimit të tij.

Marrëdhëniet me Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë: Princi Wilhelm von Wied argumentonte se kthimi në Shqipëri ishte në përputhje me interesat strategjikë të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë, dhe se një Shqipëri e pavarur dhe e fortë nën sundimin e tij përbënte një faktor stabilizues në Ballkan. Ai theksonte se

“është në interesin e përbashkët të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë që populli shqiptar të mbetet i frymëzuar për të gjitha kohët prej idesë mirënjohëse dhe miqësore për të dyja perandoritë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme, nën mbrojtjen e përbashkët atnore të të cilave ai dëshiron, dhe duhet, që të ketë zhvillim të mëtejshëm”.

³⁰ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-6. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 14 korrik 1917. Po në të njëjtën shifër gjendet edhe letra që Wied-i i dërgon kushëririt të tij, Kajzerit gjerman, ku e informon mbi dërgimin e promemories dhe përmbajtjen e saj, Valdenburg, 24 korrik 1917; *po aty*, Vj. 27-14. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 9 dhjetor 1917.

³¹ *Po aty*, Vj. 27-6. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 14 korrik 1917.

Wied-i e shihte Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë si dy “shtete protektorë natyrale” të Shqipërisë, duke argumentuar se marrëdhëniet e ngushta me to do të siguronin “miqësinë e sigurtë dhe marrëdhëniet e ngushta, politike, ushtarake dhe ekonomike.”³² Megjithatë, në këtë raport, Austro-Hungaria – me të drejtë – konsiderohej si fuqia më e angazhuar në çështjen shqiptare, të cilën Wied-i e vlerësonte për kontributin e saj në krijimin e Shqipërisë së pavarur dhe në mbrojtjen e Fronit. Në lidhje me administratën austro-hungareze, Wied-i shprehej mirënjohës për “masat e kujdesshme të aplikuara në organizimin e administratës, të arsimit, në ndërtimin e rrugëve dhe urave, në përmirësimin e mënyrës së punimit të tokës, për furnizimin e popullit dhe për mbrojtjen sanitare të tij”.³³ Këto masa, vijonte arsyetimin ai, kishin ndihmuar në forcimin e shtetit shqiptar dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së vendësve. Megjithatë, Princi paralajmëronte se këto përpjekje nuk do të kishin kuptim pa garantuar sundimin e tij legjitim në Shqipëri, duke shprehur “dëshirën e zjarrtë e të kuptueshme për kthimin përsëri atje.”

Kundërshtimi ndaj ndikimit italian: Një nga shqetësimet kryesore ishte rritja e pranisë italiane në Shqipëri dhe Ballkan, e cila, sipas Princit, mund të dëmtonte interesat strategjikë të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë. Ai paralajmëronte se, nëse Shqipëria mbetet pa mbrojtjen habsburgase, Italia – të cilën e cilësonte si “armik i fronit dhe i vendit tim” – do të shfrytëzonte këtë vakuum për të forcuar pozitat e saj dhe për të zgjeruar influencën në rajon. Wied-i shprehej qartë për ndërmarrjen e tij në këtë drejtim, duke deklaruar se, “në asnjë mënyrë nuk e mohoj angazhimin tim për të penguar me çdo mënyrë vendosjen e çfarëdo shteti armik në bregdetin e Shqipërisë,” duke iu referuar drejtpërsëdrejti synimeve italiane.³⁴

Marrëdhëniet me shqiptarët: Wied-i e përshkruante mbështetjen e shqiptarëve si një faktor legjitimues për kthimin në Shqipëri, duke e lidhur këtë proces me ndërhyrjen e Austro-Hungarisë në favor të çështjes

³² *Po aty*, Vj. 27-6. Letra që Wied i dërgon kushëririt të tij, Kajzerit gjerman, ku e informon mbi dërgimin e promemories dhe përmbajtjen e saj, Valdenburg, 24 korrik 1917.

³³ *Po aty*, Vj. 27-14. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 9 dhjetor 1917.

³⁴ *HStA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-14. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 9 dhjetor 1917.

shqiptare. Ai pretendonte se e kishte mbështetjen e popullsisë shqiptare dhe se projekti i tij gëzonte përkrahjen e plotë të elitave politike dhe ushtarake vendëse.

“Populli im jeton bashkë me mua, – nënvizonte Princi, – duke qenë i bindur... se monarkia habsburgase, pas shumë provash të dhëna për miqësinë e saj, do të ofrojë edhe një tjetër dëshmi të mbështetjes së saj, duke mundësuar kthimin tim të shpejtë në Shqipëri.”³⁵

Për sa më sipër, promemoret e Wied-it ndanin të njëjtat argumente mbi çështjen e legjitimitetit dhe nevojës për ndërhyrje të fuqive të Bllokut Qendror, por ato ndryshonin në ton dhe pritshmëri, duke reflektuar një evoluim të strategjisë. Në promemorien e parë, Wied-i mbështetej tek ideja e një sovraniteti të mbikëqyrur nga një fuqi e madhe, një model që i ngjante protektorateve të njohura të kohës. Ky dokument kishte një ton diplomatik dhe përqendrohej në argumentet e stabilitetit rajonal dhe të së drejtës ndërkombëtare për të siguruar mbështetjen e Austro-Hungarisë. Në promemorien e dytë, Wied-i ndryshon orientim duke reflektuar zhgënjimin ndaj mungesës së mbështetjes së Fuqive Qendrore. Në kushtet kur lufta po shkonte drejt fundit, ndërsa Rusia pas Revolucionit të Tetorit (1917) kishte paralajmëruar daljen prej saj, Wied-i përshtati një qasje më pragmatike dhe të orientuar drejt veprimit. Ai kërkoi të lirohej nga ushtria gjermane me qëllim që t’i përkushtohej plotësisht kthimit të tij në Shqipëri, kërkesë të cilën ia drejtoi zyrtarisht me shkrim Perandorit gjerman, më 7 mars 1918.³⁶

Për të siguruar të drejtën e përfaqësimit të Shqipërisë në Konferencën e Paqes, që pritej të mblidhej në përfundim të luftës, në dhjetor të vitit 1917, ai propozoi masa konkrete ushtarake, përfshirë edhe opsione ekstreme, si prishja e neutralitetit dhe përfshirja e Shqipërisë në luftë kundër Italisë, në krah të Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë. Wied-i pretendonte se i kishte të gjitha mundësisë për të krijuar një ushtri shqiptare me rreth 80 000-100 000 rekrutë, të cilët do të stërviteshin nga “oficerët trima të ushtrive aleate” dhe do të viheshin plotësisht në shërbim të frontit. Ai argumentonte se një forcë e tillë do të ishte e dobishme për Fuqitë Qendrore, pasi ishte “e mësuar me klimën e vendit

³⁵ *Po aty*, Vj. 27-6. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 14 korrik 1917.

³⁶ Kasmî, *Wilhem Zu Wied*, 58.

dhe e familjarizuar me terrenin”, ndërsa shqiptarët i përshkruante si “prej natyre të kënaqur me pak, të qëndrueshëm dhe të rregjur, trima, të guximshëm dhe të durueshëm”.³⁷ Më tej, shpjegonte se krijimi i një ushtrie shqiptare nuk do të kishte vetëm funksion ushtarak, por edhe një rol politik dhe shtetformues. Sipas tij,

“krijimi i një ushtrie për të siguruar shtetin nga brenda ka për të qenë një faktor i fuqishëm që do t’u japë më tepër respekt ligjeve, mbretërisë dhe dispozitave të qeverisë sime. Kjo reformë, bashkë me deklaratën e luftës dhe me detyrimin ushtarak që do të rezultojë prej këtyre masave, do t’u japë të gjithë shqiptarëve të zotë për të mbajtur armë, impulsin më të domosdoshëm.”³⁸

Strategjia e Wied-it për të riafirmuar autoritetin përmes promemorieve dhe iniciativës për krijimin e një ushtrie shqiptare përfaqëson një përpjekje, edhe pse të vonuar, për të ndërtuar kapacitetin infrastrukturor të shtetit, në kuptimin që i jep atij Michael Mann. Sipas këtij autori, ushtria nuk është thjesht një instrument dhune, por një agjent i rendit, ligjshmërisë dhe edukimit shoqëror, thelbësor për përhapjen dhe njohjen e autoritetit qendror nga ana e popullsisë.³⁹ Në këtë prizëm, përpjekjet e Wied-it nuk ishin vetëm ushtarake, por synonin të përkthenin legjitimitetin formal në një autoritet real, të ushtruar nëpërmjet një force të organizuar që do të impononte rendin, ligjin dhe do të ndërtonte respekt institucional. Megjithatë, për shkak të mungesës së kontrollit efektiv mbi territorin, këto përpjekje mbetën në nivel retorik.

Një tjetër aspekt i strategjisë së Wied-it ishte ndërtimi i një rrjeti mbështetësish brenda qarqeve politike dhe diplomatike të Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë. Dokumentet e arkivit diplomatik të Vjenës hedhin dritë mbi përpjekjet për të krijuar aleanca me figura të rëndësishme dhe për të ndikuar në politikën e Fuqive Qendrore në favor të tij.

Pas largimit nga Shqipëria dhe vendosjes në Gjermani, Wied-i punoi për të mbajtur të gjallë interesin për Shqipërinë në qarqet politike gjermane. Një nga mekanizmat që ai përdori për këtë qëllim ishte themelimi i shoqërive dhe komiteteve që promovonin kauzën e tij. Në këtë kontekst, ai mbështeti themelimin e Shoqërisë Shqiptare të Mynihut

³⁷ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-14. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 9 dhjetor 1917.

³⁸ *Po aty*, Vj. 27-14. Promemorie e Wilhelm Wied-it për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, 9 dhjetor 1917.

³⁹ Mann, “The Autonomous Power of the State”, 185-213.

(Münchner-albanischer Verein), në tetor të 1917-s.⁴⁰ Themelues të saj ishin dr. Max Müller dhe tregtari Karl Hartmann, të cilët kishin lidhje me qarqet akademike dhe ekonomike në Gjermani dhe Austro-Hungari. Karl Hartmann kishte përvojë të drejtpërdrejtë me Shqipërinë, pasi gjatë verës së vitit 1914, kishte qenë në Durrës si pjesë e vullnetarëve gjermanë që mbështetën Princin. Shoqëria e Mynihut luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e takimeve mbështetëse dhe në botimin e artikujve në shtyp që promovonin rikthimin e Wied-it. Megjithatë, raportet diplomatike austro-hungareze tregojnë se ndikimi i kësaj organizate mbeti i kufizuar përgjithësisht brenda Gjermanisë dhe nuk pati një ndikim të ndjeshëm në Austro-Hungari dhe Shqipëri.⁴¹

Krahas ndërtimit të një rrjeti mbështetësish përmes shoqërive dhe komiteteve, Wied-i shfrytëzoi edhe diplomacinë e drejtpërdrejtë për të krijuar aleanca strategjike me personalitete me ndikim në Berlin dhe Vjenë. Shoqëria e Mynihut jo vetëm shërbeu si qendër mbështetëse, por gjithashtu u bë një kanal aktiv për përpjekjet diplomatike të Wied-it, nëpërmjet lidhjeve me figura me ndikim si dr. Karl Stockhausen, dr. Max Müller, konti Friedrich Magnus Solms-Wildenfels dhe Princin Ernst Günther.

Dr. Karl Stockhausen, i njohur si shef i kabinetit të Wied-it,⁴² mbante kontakte të drejtpërdrejta me qarqet e larta politike në dy kryeqendrat e Fuqive Qendrore. Ai u pajis me një autorizim të posaçëm nga Princi për të zhvilluar bisedime me Alfred Rappaport-in, konsullin e Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Me autorizime u pajisën edhe dr. Max Müller dhe konti Friedrich Magnus Solms-Wildenfels, të cilët tashmë kishin ndërtuar një rrjet mbështetësish për Wied-in.⁴³ Princi arriti të siguronte mbështetje të vendosur edhe nga Princi Ernst Günther i Schleswig-Holstein, anëtar i Dhomës së Lordëve të Prusisë dhe gjeneral i kalorësisë në ushtrinë perandorake. Si figurë me

⁴⁰ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-2-294. Njoftim i presidentit të Shoqërisë Shqiptare të Mynihut për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Mynih, tetor 1917; *po aty*, Vj. 28-3-318. Ekstrakt mbi veprimtarinë e Shoqërisë Shqiptare të Mynihut, janar 1918.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 27-2-296. Raport i konsullit August Kral për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 18 dhjetor 1917.

⁴² Kasmir, *Wilhelm Zu Wied*, 61.

⁴³ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-3-312. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Berlin, 18 shkurt 1918.

ndikim në qarqet politike dhe ushtarake gjermane, ai nuk nguroi ta cilësonte qëndrimin e Austro-Hungarisë ndaj Wied-it si “një turp për Gjermaninë”.⁴⁴

Një tjetër element i rëndësishëm i strategjisë së Wied-it ishte shfrytëzimi i shtypit si një mjet propagandistik përmes të cilit synohej të krijohej një perceptim pozitiv për Princin si sovran legjitim, si një alternativë e besueshme për të ardhmen e vendit, duke synuar mbështetje politike dhe përmirësim të imazhit të tij të dëmtuar pas largimit në shtator të vitit 1914.⁴⁵ Një shembull domethënës që përlligj sa më sipër ishte artikulli i publikuar më 9 qershor 1917 në gazetën gjermane “Dresdener Zeitung”, ku argumentohej se largimi i Wied-it nga Shqipëria në vitin 1914 nuk nënkuptonte heqjen dorë nga fronti. Artikulli theksonte se ai vazhdonte të ishte sundimtari legjitim i Shqipërisë dhe se, pas përfundimit të luftës, do të mund të vazhdonte misionin e tij për ndërtimin e shtetit shqiptar.⁴⁶ Në artikuj të tjerë të botuar në shtypin gjerman, Wied-i paraqitej si një figurë që mund të garantonte stabilitetin në Shqipëri dhe të kufizonte ndikimin italian në rajon.

Për të siguruar një bazë të fortë mbështetëse, krahas ruajtjes së komunikimit me shqiptarët brenda vendit dhe në diasporë përmes takimeve, letrave dhe mesazheve politike me karakter mobilizues, Wied-i synoi të përdorte edhe një praktikë të zakonshme në monarkitë europiane: shpërndarjen e titujve aristokratikë. Ai tregoi gatishmëri për të shpërblyer figurat me ndikim me tituj fisnikërie kundrejt pagesave të caktuara, duke synuar të siguronte mbështetje nga elitat politike dhe ekonomike që mund të ndikonin në rikthimin e tij.⁴⁷

Një tjetër dimension i strategjisë së Wied-it ishte edhe sigurimi i burimeve financiare për të përballuar kostot e kthimit në Shqipëri, në kushtet kur të ardhurat familjare ishin të pamjaftueshme. Një shembull konkret ishte negociata me një kompani amerikane, së cilës, në këmbim të një huaje prej 10 milionë dollarësh, i propozoi monopolin për

⁴⁴ *Po aty*, Vj. 28-3-316. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Berlin, 18 shkurt 1918; *po aty*, Vj. 28-3-312. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Berlin, 18 shkurt 1918.

⁴⁵ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-3-316. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Berlin, 18 shkurt 1918.

⁴⁶ Kasmir, *Wilhelm Zu Wied*, 57.

⁴⁷ *Po aty*, 59.

ndërtimin e kinemave dhe prodhimin e filmave në Shqipëri.⁴⁸ Ky propozim dëshmon jo vetëm përpjekjen e Wied-it për të siguruar burime financiare, por edhe objektivin për ta përdorur industrinë e filmit si një mjet propagandistik për forcimin e imazhit të tij dhe për krijimin e një identiteti kombëtar modern shqiptar.

Orientimi i Austro-Hungarisë dhe i Gjermanisë: Midis skepticizmit diplomatik dhe prioriteteve strategjike

Në përcaktimin e suksesit të strategjisë së Princ Wied-it, një rol vendimtar pati qëndrimi i Fuqive të Mëdha, e në këtë kuadër ai i Austro-Hungarisë dhe i Gjermanisë.

Qëndrimi i Austro-Hungarisë: nga mbështetja fillestare te marginalizimi: Austro-Hungaria, një nga fuqitë kryesore që kishte ndikuar në vendosjen e Wied-it në fron, ndryshoi qëndrimin ndaj tij pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. Si sovran i Principatës Shqiptare, Wied-i konsiderohej nga autoritetet e larta diplomatike habsburgase si faktor kyç për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan dhe për kufizimin e ndikimit italian e serb, por zhvillimet e luftës përshtatën përparësitë strategjike të Vjenës, duke ndikuar edhe në qëndrimin ndaj tij.

Që nga shpërthimi i luftës me Serbinë (qershor 1914), Austro-Hungaria e kushtëzoi mbështetjen për Princin me angazhimin e Shqipërisë në luftë kundër Serbisë. Refuzimi i Wied-it për të braktisur neutralitetin dhe për të angazhuar shqiptarët në konfliktin ballkanik e shtyu Vjenën të rishikonte strategjinë e saj.⁴⁹ Për pasojë, ajo kërkoi një marrëveshje me Italinë për një zgjidhje alternative që përjashtonte Wied-in nga e ardhmja politike e Shqipërisë.⁵⁰ Një vit më vonë, Perandoria Osmane, tashmë aleate e Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë, mbështeti politikën habsburgase ndaj Shqipërisë, me kushtin që sundimtari i ardhshëm të kishte shtetësi shqiptare.⁵¹ Kjo tregon një zhvendosje të qartë nga një model i mbështetur mbi një monark të huaj, drejt një strategjie që favorizonte ndikimin e drejtpërdrejtë të Fuqive të Mëdha mbi Shqipërinë.

⁴⁸ *Po aty.*

⁴⁹ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-20-2056. Telegram nga Vjena për konsullin Lövental në Durrës, Vjenë, 4 gusht 1913.

⁵⁰ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939* (Tiranë: Toena, 2009), 148-149.

⁵¹ Gostentschnigg, "Shtatmadhuria kundër Ballhausplatz-it", 74.

Pavarësisht qëndrimit të Wilhelm von Wied-it, të shprehur qartë në promemorie dhe të përforcuar në takimet e zhvilluara me eksponentë të lartë të politikës dhe diplomacisë gjermane e austro-hungareze, Vjena zyrtare u tregua gjithnjë e më e rezervuar ndaj së ardhmes së tij politike.⁵² Ministri i Jashtëm, konti Ottokar Çernin, megjithëse e priti me korrektesë të dërguarin e Wied-it, refuzoi të angazhohej zyrtarisht për mbështetje. Nga viti 1916, me pushtimin e territoreve shqiptare, objektivat e politikës habsburgase ndaj Shqipërisë pësuan një transformim të dukshëm. Një vit më vonë, më 23 janar 1917, në përvjetorin e parë të hyrjes së trupave austro-hungareze në Shkodër, gjenerali Trollman shpalli zyrtarisht "Autonominë e të gjithë Shqipërisë nën mbrojtjen e Monarkisë Dualiste", duke synuar ta shndërronte vendin *de facto* në një protektorat. Si rrjedhojë, Wied-i u konsiderua i papërshtatshëm për interesat e Vjenës. Promemoret mbetën pa përgjigje, ndërsa autoritetet ushtarake në Shqipëri ndaluan vullnetarët shqiptarë të mbanin në krah shiritin me inicialet identifikuese të Princit (W. W.) dhe urdhëruan konfiskimin e çdo forme korrespondence midis tij dhe shqiptarëve. Në shtator të vitit 1918, në "Udhëzime Publike" për Shqipërinë e pushtuar ndalohej "çdo propagandë politike për anëtarët e shteteve të huaja në pushtet dhe në favor të princit Wied", me arsyetimin se një veprim i tillë "nuk është në përputhje me marrjen e planifikuar të protektoratit efektiv të monarkisë mbi Shqipërinë".⁵³

Ky tranzicion, nga përkrahja për një princ gjerman te vendosja e një administrate të drejtpërdrejtë ushtarake, dëshmon qartë për dinamikën që Stephen Krasner e përkufizon si "hipokrizi e organizuar" e sovranitetit — pra, mospërputhja ndërmjet njohjes ndërkombëtare formale dhe realitetit praktik të ushtrimit të pushtetit.⁵⁴ Në këtë rast, njohja e Principatës Shqiptare dhe legjitimitetit të Wied-it nuk përkthehej në një angazhim të vërtetë për ta mbështetur atë si autoritet efektiv. Në vend të respektimit të pavarësisë së shpallur, Austro-Hungaria zbatoi një strategji protektorati,

⁵² *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-5. Informacion nga Rappaport për konsullatën e përgjithshme austro-hungareze në Mynih, 5 shkurt 1918; *po aty*, Vj. 28-3-312. Informacion mbi takimet e Wied-it dhe të deleguarve të tij me personalitete të larta gjermane dhe austro-hungareze, Mynih, 18 shkurt 1918.

⁵³ Tamara Scheer, "Regjimet pushtuese austro-hungareze në Evropën Juglindore në Luftën e Parë Botërore dhe çështja shqiptare", në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, 44.

⁵⁴ Krasner, "Abiding Sovereignty", 242.

duke e kthyer Shqipërinë në një hapësirë me sovranitet formal. Në këtë kontekst, Wied-i mbeti figura simbolike e një marrëveshjeje ndërkombëtare të tejkaluar, pa funksionalitet real në kuadrin e ri gjeopolitik të rajonit.

Qëndrimi i Gjermanisë: një mbështetje e kufizuar dhe pragmatike: Ndryshe nga Austro-Hungaria, Gjermania e trajtoi çështjen shqiptare më shumë si një mjet diplomatik sesa si një prioritet të politikës së saj të jashtme. Ndonëse brenda qarqeve politike dhe ushtarake gjermane ekzistonin elementë të kufizuar, që e perceptonin Shqipërinë si një territor me potencial ekonomik dhe strategjik, këta zëra mbetën të pamjaftueshëm për të ndikuar në politikën e përgjithshme të Berlinit dhe për të ushtruar presion mbi qeverinë gjermane në qëndrimin e saj ndaj Wilhelm von Wied-it.⁵⁵

Si rezultat i dinamikave të Luftës së Parë Botërore dhe kompleksitetit politik të Ballkanit, qeveria gjermane mbajti një qëndrim të kujdesshëm dhe të rezervuar ndaj kërkesave të Princ Wied-it për mbështetje politike dhe ushtarake. Në tetor të vitit 1914, ministri i Jashtëm gjerman, Gottlieb von Jagow, i komunikoi atij se mungonin kushtet e nevojshme për kthimin në pushtet.⁵⁶ Ky pozicion i qëndrueshëm, i ruajtur edhe në vitet pasuese, pasqyronte logjikën diplomatike të Gjermanisë: në një kontekst të mbushur me tensione ndërkombëtare dhe balanca të brishta rajonale, Shqipëria nuk shihej si një investim strategjik që justifikonte angazhim aktiv. Kështu, heshtja ndaj memorieve dhe shmangia nga angazhimi reflektonin racionalitetin e ftohtë të politikës së jashtme gjermane, ku mbështetja për aktorë periferikë varej nga përfitimet konkrete dhe jo nga obligimet formale.

Dëshpërimi i Wied-it për pasivitetin e Gjermanisë u shpreh dukshëm në një letër të vitit 1918, drejtuar vëllait, ku ai shkruante:

“Anglia dërgon menjëherë një anije për çdo kuzhinier apo shërbëtor të saj, të cilit jashtë shtetit i preket një qime floku,... çfarë bën Gjermania për Princin e saj?”⁵⁷

Kjo dëshmi personale thekson ndjesinë e braktisjes dhe zhgënjimit që shoqëroi përpjekjet e pasuksesshme për të rikthyer rolin e tij në Shqipëri.

⁵⁵ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 28-3-312. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Berlin, 18 shkurt 1918.

⁵⁶ Kasmir, *Wilhelm Zu Wied*, 56-57.

⁵⁷ *Po aty*, 60.

Përfundime

Artikulli analizon përpjekjet e Wilhelm von Wied-it për të riafirmuar legjitimitetin mbi Principatën Shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore, duke i vënë ato në kontekstin e sfidave strukturore të shtetformimit, dinamikave ndërkombëtare dhe veprimit të elitave politike vendëse.

Së pari, analiza tregon se legjitimiteti i Wied-it ishte i brishtë që në momentin e vendosjes në fron. Si një sundimtar i caktuar nga një marrëveshje ndërkombëtare, që ushtroi funksionet e sovranit për një periudhë tejet të shkurtër, ai nuk arriti të krijonte një bazë të fortë e të qëndrueshme mbështetëse në radhët e elitave politike shqiptare në vend dhe në diasporë. Në një shoqëri ku, sipas Joel Migdal-it, strukturat e brendshme ishin patriarkale dhe më të forta se institucionet shtetërore, përpjekjet për ndërtimin e një autoriteti të centralizuar u përballën me fragmentarizim lokal dhe besimin e dobët ndaj shtetit dhe Princit. Në vitet e Luftës së Parë Botërore, interesat e Fuqive të Mëdha penguan konsolidimin e marrëdhënieve të elitave politike shqiptare me Princin dhe, në tërësi, të ardhmen politike të Wilhelm von Wied-it në Shqipëri.

Së dyti, përpjekjet e Wied-it për t'u rikthyer në pushtet u mbështetën në një strategji të shumanshme, që përfshinte diplomacinë, propagandën ndërkombëtare, krijimin e një ushtrie kombëtare dhe ndërtimin e një rrjeti mbështetësish në Austro-Hungari e Gjermani. Këto përpjekje, megjithëse të strukturuara dhe të argumentuara, nuk gjetën jehonë të mjaftueshme, për shkak të ndryshimit të prioriteteve strategjike të Fuqive Qendrore dhe mungesës së përkrahjes vendimtare diplomatike dhe ushtarake. Në kornizën teorike të sociologut Michael Mann, kjo situatë dëshmon pamundësinë e Wied-it për të zhvilluar kapacitetet infrastrukturore shtetformuese, duke e lënë legjitimitetin e tij të mbështetur kryesisht në formalitetin ndërkombëtar.

Së treti, rasti i Wilhelm von Wied-it ilustron kompleksitetin e shtetformimit në rajone të vogla dhe të brishta, të cilat ndodheshin në kryqëzimin e interesave të Fuqive të Mëdha. Ai përbën një shembull të qartë të modelit të “sundimit të ndërmjetëm”, ku autoriteti i brendshëm nuk mund të konsolidohet pa mbështetje efektive të jashtme. Në këtë mënyrë, sovraniteti i Wied-it ishte më shumë një konstrukt formal – një “hipokrizi e organizuar” në kuptimin që i jep Stephen Krasner – sesa një

realitet funksional me autoritet të ushtruar në terren. Qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe i Gjermanisë ishte vendimtar për fatin e Wied-it; ndryshimi i orientimit të tyre gjatë Luftës së Parë Botërore e çoi atë në izolim diplomatik dhe vulosi përfundimisht dështimin e projektit të tij si Princ i Shqipërisë.

Së katërti, nën dritën e teorisë së Max Weber-it, Wied-i nuk mundi të siguronte ndonjë prej formave klasike të legjitimitetit: as atë tradicional, as karizmatik, as legal-racional. Largimi i tij nga vendi dhe mungesa e institucioneve funksionale gjatë Luftës së Parë Botërore çuan në erozionin e çdo pretendimi efektiv për sovranitet. Legjitimiteti formal, i mbështetur vetëm në aktin e njohjes ndërkombëtare të vitit 1913, pa ushtrimin e pushtetit qoftë edhe në mërgim, rezultoi i pamjaftueshëm për rikthim.

Në analizën përfundimtare, sfidat politike, diplomatike dhe strukturore bënë që Wied-i të humbiste çdo mundësi reale për rikthim. Fundi i Luftës së Parë Botërore dhe disfata e Fuqive Qendrore shënuan një hap të rëndësishëm në dështimin e ambicieve të tij për t'u rikthyer në fron. Marrëveshjet e fshehta të Fuqive të Antantës, përfshirë Traktatin e Londrës (1915), treguan qartë se fuqitë fituese nuk kishin interes për rikthimin e tij, duke i orientuar planet e tyre drejt copëtimit të territoreve shqiptare. Konferenca e Paqes në Paris (1919) nuk e trajtoi seriozisht mundësinë e rikthimit të Princit në Shqipëri, ndërsa fuqitë fituese kishin interesa të tjerë në rajon. Kjo situatë konfirmoi se Wied-i, pavarësisht se ishte vendosur në fron nga Fuqitë e Mëdha, nuk kishte as bazën politike të nevojshme për të mbajtur pushtetin dhe as mbështetjen ndërkombëtare për një rikthim të mundshëm.

Me shpalljen e Republikës Shqiptare në vitin 1925 dhe vendosjen e Ahmet Zogut si president, ëndrra e Wied-it për të sunduar Shqipërinë përfundimisht mori fund. Institucionalizimi i një qeverisjeje me një bazë të fortë të brendshme dëshmoi transformimin politik të vendit në kushtet e pasluftës dhe eliminoi përfundimisht çdo perspektivë për rikthimin e princit gjerman. Kësisoj, historia e Wilhelm von Wied-it ilustron jo vetëm dështimin e tij personal, por edhe sfidat e shtetformimit në vendet e vogla dhe periferike, në një kontekst të ndërlikuar ndërkombëtar, të mbushur me interesa konkurrues midis Fuqive të Mëdha.

Burime e bibliografi:**Burime parësore:**

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH).

- Fondi i dokumenteve diplomatike austro-hungareze (Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien), 1914-1918.

Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri (ASDMAE).

- Serie Ordinario e di Gabinetto (1915–1918), Albania, Pacco 14.

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH).

- Fondi 486 dhe 13.

Botime dokumentare:

WIED, Wilhelm von. *Memorandum on Albania* (1917).

http://www.albanianhistory.net/1917_Wied/index.html (shikuar më 25 janar 2024).

NOSI, Lef. *Dokumente historike për t'i shërbyer historiës tonë kombëtare*. Botim i dytë, përgatitur dhe redaktuar shkencërisht nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka. Instituti i Historisë. Tiranë: Nënë Tereza, 2007.

Burime dytësore:

BEETHAM, David. *The Legitimation of Power*. Basingstoke: Macmillan, 1991.

DUSHKU, Ledia. “From Ottomans to Albanians: The First Balkan War and the Proclamation of Albanian Independence (October-November 1912).” *Istorija 20. Veka* 1 (2024): 2-7.

DUSHKU, Ledia. “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914–1916).” *Studime historike* 3-4 (2016): 73-90.

FRIED, Marvin Benjamin. *Austro-Hungarian War Aims in the Balkans during World War I*. Basingstoke, New York: Palgrave Macmillan, 2014.

GOSTENTSCHNIGG, Kurt. “Shtatmadhuria kundër Ballhausplatz-it: aneksim apo protektorat?” Në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*,

- Aktet e konferencës shkencore, Tiranë, 26-27 janar 1918. Redaktuar nga Dorian Koçi dhe Marenglen Kasmi. Tiranë: Kristalina-KH, 2019.
- GUY, Nicola. *The Birth of Albania: Ethnic Nationalism, the Great Powers of World War I and the Emergence of Albanian Independence*. London: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2012.
- GURRAZEZI, Refat. Xh. *Historia e Federatës "Vatra"*. Tiranë: Globus R., 2006.
- IKONOMI, Ilir. *Esad Pashë Toptani: Njeriu, lufta, pushteti*. Tiranë: UET Press, 2016.
- KADRIA, Sali. *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*. ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2020.
- KADRIA, Sali. "Çështja e Princit të Shqipërisë dhe kontributi i Austro-Hungarisë për rrjetin e komunikacionit në viset shqiptare gjatë viteve 1916-1918." *Kosova* 43 (2018): 97-104.
- KASMI, Marenglen. *Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria, mars-shtator 1914*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2023.
- LAKE, David A. *Hierarchy in International Relations*. Ithaca and London: Cornell University Press, 2009.
- MANN, Michael. "The Autonomous Power of the State: Its Origins, Mechanisms and Results." *Journal of Sociology/Archives Européennes de Sociologie* 25, no. 2 (1984): 185-213.
- MIGDAL, Joel S. *Strong Societies and Weak States: State-Building in the Third World*. Princeton: Princeton University Press, 1988.
- MILO, Paskal. "Politikat austro-hungareze ndaj Shqipërisë në vitet 1914-1918." Në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, Aktet e konferencës shkencore, Tiranë, 26-27 janar 1918, redaktuar nga Dorian Koçi dhe Marenglen Kasmi, 25-39. Tiranë: Kristalina-KH, 2019.
- PUTO, Arben. *Shqipëria politike, 1912-1939*. Tiranë: Toena, 2009.
- SCHEER, Tamara. "Regjimet pushtuese austro-hungareze në Evropën Juglindore në Luftën e Parë Botërore dhe çështja shqiptare." Në *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, Aktet e konferencës shkencore, Tiranë, 26-27 janar 1918, redaktuar nga Dorian Koçi dhe Marenglen Kasmi. Tiranë: Kristalina-KH, 2019.
- SWIRE, Joseph. *Albania: The Rise of a Kingdom*. New York: Arno Press & New York Times, 1971.

- TERAOKA, Tomonori. "Fragmented Legitimacy: The Rhetorical Construction of Constitutional Legitimacy in Postwar Japan". *Japanese Journal of Political Science* 21, nr. 2 (2020): 346-372.
- WEBER, Max. *Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology*. Redaktuar nga Guenther Roth dhe Claus Wittich. Berkeley, Los Angeles, London: University of California Press, 1978.
- KRASNER, Stephen D. "Abiding Sovereignty." *International Political Science Review* 22, no. 3 (2001): 229-251.

PROF. DR. LEDIA DUSHKU

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
ledia.dushku@asa.edu.al

S u m m a r y

**THE ABSENT THRONE: WILHELM VON WIED'S QUEST FOR
LEGITIMACY IN ALBANIA DURING THE FIRST WORLD WAR**

The article focuses on analyzing Prince Wilhelm von Wied's efforts to reaffirm his legitimacy over the Albanian throne during the years of the First World War, in a context marked by a profound vacuum both on the ground and within the framework of international political architecture. Following his departure from Albania, Wied sought to reclaim his position as the legitimate sovereign, while Albanian elites remained divided between supporters of his return and those advocating alternative political paths. The role of the Great Powers – particularly Austria-Hungary – proved decisive in shaping his fate and the level of support he would receive from Albanian political actors.

In his bid to return, Wied pursued a multifaceted strategy, initially emphasizing military means and later shifting toward diplomatic and propaganda efforts. Nevertheless, the Central Powers did not perceive his restoration as a realistic option. Focused on exerting direct control over

Albania, Austria-Hungary politically marginalized Wilhelm von Wied, restricted his communication with supporters within the country, and prohibited them from campaigning on his behalf. In contrast, Germany did not view Albania as a strategic priority and took no concrete steps to support the Prince, remaining aligned with Vienna's position.

The article concludes that the failure of Prince Wied to reclaim the Albanian throne and convert formal legitimacy into exercised authority is explained by the absence of a consolidated internal authority in Albania, shifting priorities among the Great Powers, and the lack of sustained international support.

Key words: Wilhelm von Wied, World War I, Albania; Austria-Hungary, legitimacy, memoranda, support networks.

